



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 nëntor 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit (F00349)

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtjes së të akuzuarit

Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të viktimave

Sajmon Loz

TRUPI GJYKUES I (Paneli) lëshon këtë vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit (F00349).

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 4 nëntor 2022, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dorëzoi një kërkesë që: (i) të mbikëqyreshin në mënyrë aktive komunikimet e të akuzuarit me persona jashtë objektit të paraburgimit të Dhomave të Specializuara (objekti i paraburgimit të DHS-së); (ii) komunikimet e të akuzuarit të lejoheshin vetëm me individë të një liste të miratuar paraprakisht; dhe (iii) të urdhërohej i akuzuari që të mos i bënte të ditur askujt jashtë ekipit të tij të Mbrojtjes material dhe informacion konfidencial (Kërkesa e ZPS-së).¹ ZPS-ja kërkoi gjithashtu që Trupi Gjykses të ftonte Zyrën Administrative që të bënte parashtrime në lidhje me mundësinë e zbatimit të këtyre masave.²

2. Më 10 nëntor 2022, Trupi Gjykses lëshoi një urdhër me anë të të cilit udhëzonte Zyrën Administrative që deri më 24 nëntor 2022 (16:00) të dorëzonte parashtrime, ku të përshkruante me hollësi: (i) mundësinë e zbatimit të masave të kërkuara nga ZPS-ja; (ii) kapacitetet dhe kohën e nevojshme për t'i zbatuar këto masa, nëse do të urdhëroheshin; (iii) çfarëdo masash të tjera apo masa alternative që ajo mendon se mund të përdoren, në varësi të vendimit të Trupit Gjykses, për të trajtuar rreziqet e identifikuar nga ZPS-ja; dhe (iv) aspekte të tjera që ajo i gjykon të përshtatshme t'i paraqiste në lidhje me Kërkesën e ZPS-së (përkatësisht, Raporti i Zyrës Administrative dhe Urdhri për Zyrën Administrative).³

¹ KSC-BC-2020-04, F00336, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Kufizimin e Komunikimeve të të Akuzuarit*, 4 nëntor 2022, konfidenciale, para. 1, 12-14.

² Kërkesa e ZPS-së, para. 13.

³ KSC-BC-2020-04, F00344, Trupi Gjykses I, *Urdhër për Parashtrime mbi Kërkesën e Prokurorisë për Kufizimin e Komunikimeve të të Akuzuarit (KSC-BC-2020-04/F00336)*, 10 nëntor 2022, konfidencial, para. 5.

3. Më 14 nëntor 2022, Mbrojtja kërkoi që të ndryshonte afati i përgjigjes së saj ndaj Kërkesës së ZPS-së deri më 5 dhjetor 2022 (Kërkesa e Mbrojtjes).⁴

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Trupi Gjykses mbështetet në nenet 40(2) dhe (6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullat 9(5)(a), 9(6) dhe 76 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

III. DISKUTIM

5. Fillimisht, Trupi Gjykses konstaton se Kërkesa e Mbrojtjes është dorëzuar paraprakisht në kohë të mjaftueshme për përgjigjen e saj ndaj Kërkesës së ZPS-së, konkretisht më 16 nëntor 2022, sikurse përcaktohet në rregullën 76 të Rregullores.

6. Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja ka paraqitur arsye të vlefshme, sikurse përcaktohet në rregullën 9(5)(a) të Rregullores, duke marrë parasysh se Mbrojtja ka shpjeguar në mënyrë bindëse se për t'iu përgjigjur Kërkesës së ZPS-së: (i) ka nevojë për informacionin shtesë që i është kërkuar Zyrës Administrative lidhur me të dhënat mbi komunikimet dhe vizitat e të akuzuarit; dhe (ii) në përgjigjen e saj dëshiron të trajtojë gjithashtu Raportin e Zyrës Administrative që pritet sipas Urdhrit më 24 nëntor 2022.⁵

7. Trupi Gjykses më tej thekson se ZPS-ja ka të drejtë t'i përgjigjet Raportit të Zyrës Administrative, dhe mban parasysh se ky raport mund ta ndihmojë më tej

⁴ KSC-BC-2020-04, F00349, Mbrojtja, *Kërkesë e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Përgjigjen e saj ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Kufizimin e Komunikimeve të të Akuzuarit*, 14 nëntor 2022, konfidenciale, para. 1, 10.

⁵ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 7-9.

Mbrojtjen që para se të dorëzojë përgjigjen e saj ndaj Kërkesës së ZPS-së të marrë përgjigjen e ZPS-së ndaj Raportit të Zyrës Administrative. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses, *proprio motu*, urdhëron ZPS-në të dorëzojë përgjigjen ndaj Raportit të Zyrës Administrative, në qoftë se dëshiron, deri të **hënë, 28 nëntor 2022 (16:00)**. Mbrojtësi i viktimave, në qoftë se dëshiron, mund t'i përgjigjet brenda së njëjtës datë si Kërkesës së ZPS-së po ashtu edhe Raportit të Zyrës Administrative.

8. Ndërsa Mbrojtja kërkon ndryshim të afatit për mundësimin e dorëzimit të përgjigjes ndaj Kërkesës së ZPS-së deri më 15 dhjetor 2022, Trupi Gjykses mendon se zgjidhja e debateve juridike rreth Kërkesës së ZPS-së është e dëshirueshme sa më shpejt që të jetë e mundshme në dobi të procesit dhe se ndryshimi i afatit deri më 5 dhjetor 2022 nuk është i përligjur. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen të dorëzojë një përgjigje përmbledhëse ndaj Kërkesës së ZPS-së, Raportit të Zyrës Administrative, Përgjigjes së ZPS-së ndaj Raportit të Zyrës Administrative, në qoftë se do të ketë,⁶ deri të **premtën, 2 dhjetor 2022 (16:00)**. Për të njëjtat arsye, ZPS-ja dhe mbrojtësi i viktimave mund t'i kundërpërgjigjen, në qoftë se dëshirojnë, përgjigjes së Mbrojtjes deri të **mërkurën, 7 dhjetor 2022 (16:00)**.

9. Së fundi, në pajtim me rregullën 9(6) të Rregullores, Trupi Gjykses gjykon se nuk ZPS-së apo mbrojtësit të viktimave nuk i shkaktohet dëm nga marrja e vendimit mbi Kërkesën e Mbrojtjes pa iu dhënë atyre mundësi që të përgjigjen.

IV. VENDIM

10. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a. **MIRARON**, pjesërisht, Kërkesën e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit;

⁶ *Shih* para. 7 më lart.

- b. **URDHËRON** ZPS-në dhe mbrojtësin e viktimave të dorëzojnë përgjigje ndaj Kërkesës së ZPS-së, në qoftë se dëshirojnë, deri të **hënën, 28 nëntor 2022 (16:00)**;
- c. **URDHËRON** Mbrojtjen, në qoftë se dëshiron, të dorëzojë një përgjigje përmbledhëse ndaj Kërkesës së ZPS-së, Raportit të Zyrës Administrative, dhe ZPS-në dhe mbrojtësin e viktimave t'i përgjigjen Raportit të Zyrës Administrative, në qoftë se do të kenë, deri të **premtën, 2 dhjetor 2022 (16:00)**; dhe
- d. **URDHËRON** ZPS-në dhe mbrojtësin e viktimave të dorëzojnë kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së Mbrojtjes, në qoftë se dëshirojnë, deri të **mërkurën, 7 dhjetor 2022 (16:00)**.

/nëshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nëshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nëshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E martë, 15 nëntor 2022

Në Hagë, Holandë.